FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.179 dhjetor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.901, datë 21.12.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Portëz të qarkut të Fierit.....	10089
Vendim i KM nr.902, datë 21.12.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Çorovodë të qarkut të Beratit	10090
Vendim i KM nr.903, datë 21.12.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Trebisht të qarkut të Dibrës.....	10091
Vendim i KM nr.904, datë 21.12.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Zhejë" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	10092
Vendim i KM nr.905, datë 21.12.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Shpella Poshtë" dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	10092
Vendim i KM nr.906, datë 21.12.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Begaj" dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	10093
Udhëzim i MF dhe RTSH nr.29, datë 27.12.2011	Për disa shtesa në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive", të ndryshuar.....	10094
Vendim i GJL nr.7, datë 14.10.2011	Me objekt caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg"	10096

VENDIM
Nr.901, datë 21.12.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PORTËZ TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Portëz të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 481 (katërqind e tetëdhjetë e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Portëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Portëz Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
73	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
74-84	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
85-92	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
93,94,99,100,102,109-131, 139-146	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
154-165	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
166-180	Varrezat publike	Në pronësi
181-210	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
214-227	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
95-98,101,103-108,132, 133-138,147-151,353, 439-441,444-448,451, 452,453/1,453/2	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
438,442,443,449,450,453, 454	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
455-458	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.902, datë 21.12.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË ÇOROVODË TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Çorovodë të qarkut të Beratit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 970 (nëntëqind e shtatëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Çorovodë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Çorovodë — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
8-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve social-kulturore e sportive	Në pronësi
22-23,25-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
31,36,37,42,51	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
65-614,616,617	Troje të lira dhe hapësira të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
615	Varreza publike	Në pronësi
619-622	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
623-627	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
628-782,792-818	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
787-788	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
789	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr.903, datë 21.12.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS TREBISHT TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Trebisht të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 31 (tridhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Trebisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Trebisht Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
7,10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
18-23	Varrezat publike	Në pronësi
123-124,128-129,134-135, 140-141,145-148	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
126,131-132,137-138, 143,150-151	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
153-156	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.904, datë 21.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "ZHEJË" DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Zhejë" është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë "Piroli" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Zhejë", të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.905, datë 21.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "SHPELLA POSHTË" DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, 23 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Shpella Poshtë" është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Thoreneks" sh.p.k., për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Shpella Poshtë", të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.906, datë 21.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "BEGAJ" DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Begaj", është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë "Alpower" sh.p.k., për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Begaj", të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Fletorja Zyrtare
e Republikës së Shqipërisë

UDHËZIM
Nr.29, datë 27.12.2011

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 8.1.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARTEVE TELEVIZIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive", të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 , me këtë përmbajtje:

"2.1 Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive, konsumatorët e mëposhtëm familjarë:

a) Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar", të ndryshuar, ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë zyrës së "CEZ shpërndarje" sh.a., në momentin e pagesës së faturës së energjisë elektrike, librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga tarifa. Nëpunësi i zyrës së "CEZ shpërndarje" sh.a., mban një kopje të librezës, në të cilët vendoset shënimi "përjashtuar nga tarifa".

2.2 Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive, konsumatorët e mëposhtëm jofamiljarë:

a) përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në bazë të parimit të reciprocitetit;

b) bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave;

c) faturimi i energjisë elektrike për aktivitete, të tilla si: miniera, ujësjellësa, puset e naftës, furnizimi i antenave të telefonisë celulare dhe garazhe të mjeteve lëvizëse;

d) në rastet kur palë në kontratën e konsumit të energjisë elektrike është një subjekt që operon në sektorin e ndërtimit, tarifa llogaritet dhe paguhet nga momenti i kalimit të kontratës në emër dhe për llogari të personit fizik, juridik apo individit pronar i ambientit për të cilin faturohet energjia.

2.3 Institucionet e përcaktuara në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi i përcjellin kompanisë "CEZ shpërndarje" sh.a., brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse, nëse ka."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE	DREJTOR I PËRGJITHSHËM I RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
Ridvan Bode	**Petrit Beci**

10094

SHTOJCA NR.1
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT MBI KATEGORITË E PËRJASHTUARA

Emërtimi	**Përshkrimi i kategorive** Të verbërit/paraplegjikë/tetraplegjikë	**Institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit mbi kategoritë e përjashtuara** Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
Invalidët dhe veteranët e Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar", të ndryshuar, ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".	Veteranë lufte	Ministria e Mbrojtjes
	Invalid pune	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
Përfaqësitë diplomatike të akredituara në	Ambasadat	Ministria e Punëve të Jashtme
Republikën e Shqipërisë në bazë të parimit të reciprocitetit	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë,	Komiteti Shtetëror për Kultet
Bashkësitë fetare	Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë	
Faturimi i energjisë elektrike për aktivitete të tilla si: miniera, ujësjellësa, puset e naftës,	Antena celular	AKEP (Agjensia e Komunikimeve Elektronike)
furnizimi i antenave të telefonisë celulare dhe garazhet e mjeteve lëvizëse	Ujësjellës	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
	Puse nafte	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
	Garazhet e mjeteve lëvizëse	Sipas përcaktimeve të bëra në faturën e energjisë
	Miniera	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

VENDIM
Nr.7, datë 14.10.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Besnik Imeraj	anëtar
Gani Dizdari	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Majlinda Andrea	anëtare
Edmond Islamaj	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 14.10.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.6/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë.

I PANDEHUR: *Ilir Kumbaro, i biri i Nazmiut dhe Fitnetes i datëlindjes 27.10.1953, lindur në Peqin dhe banues në Tiranë, aktualisht me qëndrim në Mbretërinë e Bashkuar, me kombësi e shtetësi shqiptare, i martuar me dy fëmijë, me gjendje gjyqësore "i padënuar", i mbrojtur nga avokatët Vojo Bregu dhe Bledar Fejzo, sipas prokurës së posaçme nr.1100 rep. dhe nr.213 kol., datë 8.4.2009 të përpiluar nga noterja Vojsava Karapici, me porositës shtetasin Ervin Kumbaro, i biri i të pandehurit, Ilir Nazmi Kumbaro.*

AKUZUAR: *Për kryerjen e veprës penale "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit", kryer në bashkëpunim në tri raste, "Tortura me pasoja të rënda", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 në lidhje me nenin 25 (tri herë) dhe neni 87 në lidhje me nenin 25 (tri herë) të Kodit Penal.*

OBJEKTI: *Caktimi i masës së sigurimit personal "arrest në burg".*

BAZA LIGJORE: *Neni 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.*

Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.154, datë 15.12.2009, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me objekt: caktim mase sigurimi për të pandehurin Ilir Kumbaro.

1. Caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale për të pandehurin Ilir Kumbaro.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.5, datë 5.1.2010, ka vendosur:

Miratimin e vendimit nr.154, datë 15.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë me nr.5, datë 5.1.2010, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur rekurs i

pandehuri Ilir Kumbaro, nëpërmjet mbrojtësit të tij, duke kërkuar në mënyrë alternative prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ose ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij, për këto shkaqe:

- Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë i ka mohuar të drejtën të pandehurit për t'u mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij, pasi zhvilloi seancën për caktimin e masës me një mbrojtës të caktuar kryesisht. Kishim njoftuar gjykatën për pamundësinë e paraqitjes për shkak të nevojës së pjesëmarrjes në një gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë.

- Vendimi për caktimin e masës së sigurimit është marrë nga një gjykatë jokompetente. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar në asnjë rast që gjykata që gjykon themelin e çështjes të mund të caktojë në mënyrë fillestare një masë sigurimi.

- Moskompetenca e gjykatës që gjykon themelin e çështjes për të caktuar në mënyrë fillestare një masë sigurimi nuk përcaktohet në mënyrë të shprehur në ligjin procedural, por rezulton nga interpretimi *a contrario* i dispozitave në lidhje me papajtueshmërinë e gjyqtarit gjatë procedimit.

- Gjykata duhet të arsyetonte në vendim se cilat ishin ato rrethana të reja të krijuara, që tre vjet pasi ka filluar ky procedim u shfaqën dhe shtruan nevojën e caktimit të masës së sigurimit.

- Organi i akuzës përdor dy standarde kur për dy të pandehur procedon pa asnjë masë sigurimi, ndërsa vetëm për njërin kërkon marrjen e masës ekstreme të sigurimit.

- Argumenti se ky i pandehur i fshihet hetimit nuk është i provuar. Nuk ka asnjë akt në fashikull që të provojë se ky i pandehur ka dijeni për ekzistencën e këtij procedimi në ngarkim të tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.s'ka, datë 3.3.2010, ka vendosur:

Kalimin e çështjes penale në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Me këtë vendim Kolegji Penal shtron për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara çështjet si më poshtë:

1. A ka të drejtë organi i prokurorisë të kërkojë caktimin e një mase të sigurimit personal në fazën e gjykimit të çështjes në themel ndaj të pandehurit, për të cilin nuk është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal gjatë hetimit paraprak?

2. Nëse po, a është kompetente për të shqyrtuar këtë kërkesë gjykata e cila është duke gjykuar themelin e çështjes, parë kjo në referencë të përmbajtjes së dispozitës së nenit 15/2 të Kodit të Procedurës Penale?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Majlinda Andrea dhe Ardian Dvorani; prokurorin Artur Selmani, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; mbrojtësin e të gjykuarit Ilir Kumbaro, avokatin Vojo Bregu, i cili përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe atij të Gjykatës për Krimet e Rënda dhe mosmiratimin e vendimit nr.154, datë 15.12.2009 të Gjykatës për Krime të Rënda, me të cilin është caktuar ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro masa e sigurimit "arrest në burg"; dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

VËREJNË:

I. *Rrethanat e faktit*

1. Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, u rezultojnë të pranuara prej këtyre gjykatave rrethanat, si vijojnë:

Në fazën e hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 25.10.1995, ka regjistruar procedimin penal me nr.449, për veprën penale "*Rrëmbim personi*" e kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit maqedonas me kombësi shqiptare Remzi Hoxha, parashikuar nga neni 109/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

E njëjta prokurori, në datën 17.1.2003, ka regjistruar edhe procedimin penal nr.131 për veprën penale "Rrëmbim personi" në dëm të shtetasit Ziso Kristopulli. Duke qenë procedime të lidhura është vendosur bashkimi i tyre në një procedim të vetëm, në atë me nr.449 të vitit 1995.

Hetimet paraprake në këtë procedim janë kryer në ngarkim të të pandehurve Ilir Kumbaro, Arben Sefgjini, Avni Koldashi dhe Budjon Meçe.

Ndër të tjera, me kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1229 akti, datë 18.12.2003 ka vendosur caktimin e masës së sigurimit "*arrest në burg*" ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Mbi bazën e kësaj mase sigurimi, pas kërkimeve pa sukses për gjetjen e të pandehurit Ilir Kumbaro dhe ekzekutimin e saj, është proceduar me shpalljen në kërkim ndërkombëtar të këtij të pandehuri.

Hetimet kanë vijuar në mungesë të të pandehurit Ilir Kumbaro deri kur Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të bëjë një cilësim të ri juridik të veprës, duke ndryshuar akuzën nga "*Rrëmbim personi*" kryer në bashkëpunim, sipas nenit 109/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, në "*Shpërdorim detyre*" të kryer në bashkëpunim, sipas parashikimeve të nenit 248 në lidhje me nenin 25 të këtij Kodi. Për shkak të cilësimit të ri juridik që iu bë veprës penale, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8202, datë 27.3.1997 "*Për amnistinë*", organi i prokurorisë ka ardhur në përfundimin se ishte vendi për të pushuar akuzat e ngritura në ngarkim të të pandehurve. Prandaj, me vendimin e saj të datës 1.7.2004, prokurori ka vendosur pushimin e akuzave në ngarkim të të pandehurit Ilir Kumbaro e të pandehurve të tjerë dhe pezullimin e hetimeve të këtij procedimi.

Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr.146, datë 8.9.2006, ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të datës 1.7.2004 për pushimin e akuzave dhe pezullimin e hetimeve, si dhe vazhdimin e hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda, për shkak se vepra penale për të cilën duhet të hetoheshin të pandehurit u përcaktua ajo e parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal.

Në vijim dhe në zbatim të këtij vendimi të Prokurorit të Përgjithshëm, në datën 13.10.2006, Prokuroria pranë Gjykatës për Krimet e Rënda ka regjistruar edhe procedimin penal nr.94 për veprën penale "*Rrëmbim personi*" sipas nenit 109/1 të Kodit Penal, në dëm të shtetasve Remzi Hoxha, Ziso Kristopulli dhe më pas edhe ndaj shtetasit Avdyl Loshaj.

Pas disponimeve të tjera mbi ndryshimin e akuzës gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, në datën 18.4.2008 ka paraqitur në Gjykatën për Krime të Rënda kërkesën për gjykim duke akuzuar të pandehurit Ilir Kumbaro, Arben Sefgjini, Avni Koldashi dhe Budjon Meçe për veprat penale "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/1 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (tre herë) dhe "Tortura me pasoja të rënda" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 87 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal (tre herë), në dëm të tre shtetasve: Remzi Hoxha, Ziso Kristopulli dhe Avdyl Loshaj.

2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, i pandehuri Ilir Kumbaro nuk rezulton që të jetë paraqitur në seancë gjyqësore. Gjykata për Krime të Rënda, pas kryerjes së veprimeve për njoftimin dhe më pas kërkimin e tij, ka konkluduar se ai i fshihet drejtësisë, duke deklaruar edhe mungesën e tij në gjykim dhe caktimin e avokatit kryesisht për mbrojtjen e interesave të tij.

Në vijim të gjykimit, pas zhvillimit të një numri seancash gjyqësore, ndërkohë që nga autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar kishte filluar procedura e ekstradimit të të pandehurit

Ilir Kumbaro, janë paraqitur avokatët Vojo Bregu dhe Bledar Fejzo, të caktuar për mbrojtjen e këtij të pandehuri me prokurë të posaçme të lëshuar nga i biri i tij, Ervin Kumbaro. Avokatët i paraqitën gjykatës një kërkesë, me objekt shuarjen e masës së sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro me vendimin nr.1229 akti, datë 18.12.2003 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në thelb, me anë të kësaj kërkese, mbrojtja e të pandehurit Ilir Kumbaro parashtronte se, në kushtet kur ishte pushuar procedimi penal në ngarkim të tij, gjatë të cilit ishte caktuar nga gjykata edhe masa e sigurimit "arrest në burg" ndaj tij, atëherë ky vendim për caktimin e masës së sigurimit ka humbur çdo fuqi juridike, është shuar.

Gjykata për Krime të Rënda, me vendimin nr.26/79 akti të datës 16.6.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së lartpërmendur të mbrojtësve të të pandehurit Ilir Kumbaro.

E investuar mbi ankimin e avokatëve të të pandehurit Ilir Kumbaro, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.17, datë 16.7.2009, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga ana e mbrojtjes, për shkak se nuk legjitimoheshin të paraqisnin një kërkesë të tillë, pasi i pandehuri Ilir Kumbaro nuk i kishte autorizuar për këtë lloj kërkimi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.202, datë 30.9.2009, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë, duke caktuar si detyrë që ajo të merrte në shqyrtim dhe të dispononte lidhur me shkaqet e paraqitura në ankimin e bërë nga mbrojtja e të pandehurit Ilir Kumbaro.

Në rigjykim, pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankimin e të pandehurit Ilir Kumbaro, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda arriti në përfundimin se vendimi nr.26/79 akti, datë 16.6.2009 i Gjykatës për Krime të Rënda, që rrëzoi kërkesën e paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit Ilir Kumbaro, duhej të mbetej në fuqi.

E vënë në lëvizje mbi rekursin e mbrojtësve së të pandehurit Ilir Kumbaro, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.274, datë 2.12.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr.27, datë 26.10.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr.26/79 akti, datë 16.6.2009 të Gjykatës për Krime të Rënda, duke pranuar kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit personal "arrest në burg" ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro, të caktuar me vendimin nr.1229, datë 18.2.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këtë vendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, arsyeton se: "*Me pushimin e akuzave në ngarkim të tyre automatikisht dhe masa e sigurimit personal vendosur ndaj tyre ka humbur fuqinë e saj. Kjo masë është shuar në momentin që është vendosur pushimi i çështjes. Në këtë moment ipso lege kjo masë sigurimi shuhet, kjo parashikuar në nenin 261 të Kodit të Procedurës Penale"*.

3. Pas dhënies së vendimit të lartpërmendur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për shuarjen e masës së sigurimit në ngarkim të së pandehurit Ilir Kumbaro, në vijim, në datën 9.12.2009, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka depozituar në sekretarinë gjyqësore të kësaj gjykate kërkesën drejtuar trupit gjykues që po shqyrtonte në themel këtë çështje penale, me objekt: caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për të pandehurin Ilir Nazmi Kumbaro. Kjo kërkesë e organit të akuzës, në thelb, motivohej nga fakti që tashmë i pandehuri Ilir Kumbaro nuk ka ndonjë masë sigurimi dhe se në rastin e tij ekzistonin kushtet dhe kriteret për t'i caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg".

Gjykata për Krimet e Rënda ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit në seancën e datës 15.12.2009. Kjo gjykatë pasi dëgjoi palët, bazuar në aktet e provat e fashikullit të gjykimit dhe atyre të marra deri në atë moment të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, *me vendimin nr.154, datë 15.12.2009* ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro të caktojë masën e sigurimit personal "arrest në burg".

Nëpërmjet ankimit, mbrojtësit e të pandehurit Ilir Kumbaro kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, e cila, me vendimin e saj nr.5, datë 5.1.2010 ka vendosur: "*Miratimin e vendimit nr.154, datë 15.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë"*.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë me nr.5, datë 5.1.2010, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë i pandehuri Ilir Kumbaro, nëpërmjet mbrojtësit të tij, duke kërkuar në mënyrë alternative prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ose ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 3.3.2010, bazuar mbi shkaqet e pretenduara në rekurs, rrethanat ligjore të çështjes dhe nevojën e unifikimit të praktikës gjyqësore për raste të ngjashme, ka vendosur të kalojë çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njësimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

II. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara

4. Në seancë gjyqësore, përfaqësuesi i prokurorisë parashtroi përpara Kolegjeve të Bashkuara se nuk gjen mbështetje në ligjin procedural penal, pretendimi i mbrojtjes së të gjykuarit se masa e sigurimit nuk mund të kërkohet dhe gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi personal ndaj tij gjatë fazës së gjykimit të çështjes penale. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, që ka miratuar vendimin e Gjykatës për Krime të Rënda për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" për të pandehurin Ilir Kumbaro, është dhënë në zbatim të drejtë të ligjit dhe duhet të mbetet në fuqi.

Sipas parashtrimit të prokurorit, në kuptim e zbatim të drejtë të ligjit, nuk rezulton që Kodi i Procedurës Penale të përcaktojë se kërkesa e prokurorit dhe caktimi i masës së sigurimit nga gjykata mund të bëhet vetëm në fazën e hetimit paraprak. Prokurori mund të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së sigurimit në çdo fazë e shkallë të procedimit penal, deri sa gjykata nuk ka dhënë vendim përfundimtar. Kur kërkesa për masë sigurimi paraqitet gjatë fazës së gjykimit, kompetenca për shqyrtimin e saj i përket vetëm trupit gjykues që shqyrton themelin e akuzës.

Ligji procedural penal përcakton rregulla të tilla që bëjnë dallim thelbësor mes fazës së hetimit paraprak dhe fazës së gjykimit. Në fazën e gjykimit, gjykata duhet të marrë vendime pa qenë e ndikuar nga vendimmarrja e mëparshme, qoftë edhe kur ato bazohen në dyshimet e arsyeshme. Për këtë qëllim parashikohet ndalimi i nenit 15, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilit gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit nuk merr pjesë në gjykimin e themelit të akuzës.

Po kështu ka dallim mes gjykimit lidhur me caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimit lidhur me themelin e akuzës. Për caktimin e masës së sigurimit gjykata disponon bazuar në dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në prova. Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Edhe vetë Kodi i Procedurës Penale i ka njohur palëve mundësinë që, gjatë fazës së gjykimit, t'i kërkojnë vetë gjykatës së themelit të revokojë apo zëvendësojë masën e sigurimit (neni 260).

Masa e sigurimit e caktuar nga gjykata ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro është e mbështetur në prova dhe në ligj. Gjykata, bazuar në provat dhe aktet e procedimit, ka vlerësuar se ekzistojnë rreziqet e parashikuara në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale. Veprat penale të akuzës janë të rënda dhe me sanksione të rënda, ndërkohë që i pandehuri i fshihet drejtësisë duke jetuar në një shtet tjetër e duke u paraqitur me identitet të rremë për këtë qëllim. Masat e sigurimit kanë karakter personal dhe vlerësohen sipas rrethanave konkrete për secilin të pandehur.

5. Nga ana tjetër, krahas pretendimeve lidhur me mënyrën e vlerësimit të provave dhe rrethanave nga gjykatat më të ulëta, në parashtrimin e qëndrimit të tij përpara Kolegjeve të Bashkuara, mbrojtësi i të gjykuarit Ilir Kumbaro, në thelb, parashtroi se vendimi i dhënë nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural.

Mbrojtja parashtroi se, në fazën e gjykimit, ligji procedural penal e ndalon gjykatën që shqyrton themelin e akuzës që të caktojë edhe masa të sigurimit personal të kërkuara nga prokurori. Kjo vjen në kundërshtim me nenin 15, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale.

Prokurori nuk ka të drejtë dhe gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi, nëse një gjë e tillë nuk është kërkuar prej tij dhe nuk është gjykuar nga gjykata në fazën e hetimit paraprak. Kjo rezulton nga përmbajtja e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin, për fazën e gjykimit, i parashikon gjykatës kompetencë për të vendosur revokim a zëvendësim, vetëm në lidhje me masa sigurimi të caktuara më parë në fazën e hetimit paraprak.

Edhe nëse do të lejohej kërkesa dhe caktimi i masës së sigurimit në fazën e gjykimit, lidhur me këtë kërkesë nuk mund të shprehej gjykata që shqyrton themelin e akuzës, por një gjykatë tjetër. Një përfundim i tillë mund të nxirret nga përmbajtja e neneve 17, shkronjat "b" dhe "c", si dhe 18 të Kodit të Procedurës Penale. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar si në drejtim të fajësisë, ashtu edhe të pafajësisë.

Gjykata për Krime të Rënda Tiranë i ka mohuar të drejtën të pandehurit për t'u mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij, pasi zhvilloi seancën për caktimin e masës me një mbrojtës të caktuar kryesisht. Kishim njoftuar gjykatën për pamundësinë e paraqitjes për shkak të nevojës së pjesëmarrjes në një gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Organi i akuzës përdor dy standarde kur për dy të pandehur procedon pa asnjë masë sigurimi, ndërsa vetëm për njërin kërkon marrjen e masës ekstreme të sigurimit. Argumenti se ky i pandehur i fshihet hetimit, nuk është i provuar. Nuk ka asnjë akt në fashikull që të provojë se ky i pandehur ka dijeni për ekzistencën e këtij procedimi në ngarkim të tij.

6. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë që gjykatat më të ulëta kanë interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin procedural penal. Masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, meqenëse, në rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, rezulton se janë përmbushur kushtet dhe kriteret për caktimin e tyre të parashikuara nga ligji procedural penal.

Prandaj, nuk ka mbështetje në ligj pretendimi i ngritur në rekursin e mbrojtësit të të pandehurit Ilir Kumbaro se, në fazën e gjykimit, gjykata nuk mund të caktojë më masë sigurimi. Ajo vetëm mund të revokojë apo zëvendësojë një masë sigurimi që është caktuar njëherë në fazën e hetimit paraprak. Gjykata në fazën e gjykimit nuk mund të caktojë masa sigurimi dhe më pas të zgjidhë në themel çështjen.

Kështu, në thelb, sikurse rezultoi nga rrethanat e çështjes si më sipër të pranuara nga gjykatat, në përfundim të fazës së hetimit paraprak, nga ana e prokurorit është paraqitur në Gjykatën për Krime të Rënda kërkesa për gjykim. Sipas prokurorit, hetimet ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro janë zhvilluar në kushtet e kufizimit të lirisë së tij, përmes masës së sigurimit "arrest në burg". Kjo masë sigurimi, gjithnjë sipas qëndrimit që ka pasur organi i prokurorisë në këtë procedim, ka ekzistuar, por nuk është ekzekutuar, pasi i pandehuri nuk ishte e mundur të gjendej, prandaj gjykata kishte deklaruar edhe ikjen e tij (neni 247). Pra, për organin e prokurorisë, i pandehuri Ilir Kumbaro ka qenë në gjendje arresti në burg gjatë fazën së hetimit paraprak.

Në këtë gjendje procedurale të të pandehurit është paraqitur kërkesa për gjykim dhe Gjykata për Krime të Rënda ka filluar shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Gjatë gjykimit, kjo gjykatë nuk pranoi kërkesën e mbrojtjes së të pandehurit për shuarjen e masës së sigurimit, sipas nenit 261 të Kodit të Procedurës Penale, sepse sipas mbrojtjes ajo ishte shuar qysh në fazën e hetimit paraprak, kur i

njëjti procedim objekt gjykimi ishte pushuar njëherë nga prokurori. Mbi ankimin e mbrojtësve të të pandehurit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë përfundimisht vendosi që masa e sigurimit ishte shuar qysh në çastin kur procedimi ishte pushuar nga prokurori, pavarësisht se ai vendim pushimi ishte revokuar më pas nga prokurori më i lartë.

Në të tilla rrethana, në seancë gjyqësore, prokurori i paraqiti kërkesë gjykatës për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro, për shkak se ekzistonin rreziqet që parashikonte neni 228 e 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata për Krimet e Rënda e pranoi kërkesën e prokurorit dhe ky vendim u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

7. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta janë dhënë në zbatim të drejtë të ligjit procedural penal. Masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, nëse verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit.

Por, në përgjigje të çështjeve të parashtruara për njësimin e praktikës gjyqësore dhe të pretendimeve të parashtruara në rekursin e të gjykuarit për shkelje të rënda procedurale në gjykim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se nevojitet të interpretohet kuptimi dhe përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale mbi kushtet paraprake për caktimin e masës së sigurimit, kushtet e kriteret e lidhura me "rrezikun" që justifikon këto masa, atyre lidhur me "përshtatshmërinë" e masave të sigurimit, rrethanave se kur vendimi gjyqësor mbi këto masa ka forcën e gjësë së gjykuar, si dhe për kompetencën, natyrën e dallimin e objektit të gjykimit kur gjykata, në çdo fazë të procedimit, investohet, arsyeton e disponon mbi masën e sigurimit nga rasti i vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit të së pandehurit.

8. Në pikën 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

"*1. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova*".

Nëpërmjet analizës dhe interpretimit të drejtë të kësaj dispozite, posaçërisht të shprehjes "*dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova*", në harmoni me institutet e tjera procedurale, mund të bëhet dallimi dhe të arrihet në përfundime të drejta, jo vetëm lidhur me kushtet paraprake për caktimin e masës së sigurimit, por edhe se përse kjo masë mund të caktohet edhe në fazën e gjykimit të çështjes penale. Për rrjedhojë mund të kuptohet dhe të dallohet gjykimi mbi dyshimin e arsyeshëm bazuar në prova për caktimin e masës së sigurimit nga gjykimi i provës për efekt të formimit të bindjes mbi të vërtetën, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, në dhënien e vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit të të pandehurit.

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1 të nenit 228, nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, pra për ekzistencën e atyre elementeve të mjaftueshme juridike dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale.

Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit a të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij.

Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë ezaurues, domosdoshmërisht njëdrejtimësh, pra në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se ***dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse***

provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij.

Dispozita e pikës 1 të nenit 228 tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë vepër penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij.

9. Nga ana tjetër, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim të të gjykuarit (*fumus delicti*) është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të gjykuarit (*periculum libertatis*). Procesi i vlerësimit dhe gjykimit për vendosjen ose jo të masës së sigurimit sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara nga ligji, mbështetet dhe synon arritjen e ekuilibrit të nevojshëm, nga njëra anë, për respektimin dhe garantimin e rendit publik e të interesit publik për dhënien e drejtësisë dhe nga ana tjetër, me të drejtat dhe interesat ligjorë të individit subjekt i procedimit, të dyja të parashikuara nga Kushtetuta.

Prandaj, në vijim, në pikën 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se:

"3. *Masat e sigurimit personal vendosen*:

a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;

b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.".

Paraprakisht, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se kushtet dhe kriteret e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mosekzistencën e kushteve dhe kritereve të tjera, që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të gjykuarit.

Nga interpretimi i drejtë i kuptimit që duhet t'i jepet termit "rrezik" në nenin 228 në tërësi, pra edhe për rastin e shkronjës "a" të këtij neni, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se, ***në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit duhet të motivohen dhe të argumentojnë (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të "rrezikut", pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit) vënia në rrezik e procesit të të provuarit nga ana e të pandehurit.***

Kjo gjendje "rreziku" mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, në dinamikë, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit që e sjellin atë gjykatë në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendjeje, e cila pengon, ngadalëson apo devijon në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal përkatës, në kuadër të garantimit të procesit të dhënies së drejtësisë në tërësi të parashikuar nga Kushtetuta e që pikërisht justifikon parashikimin në ligj të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit.

Vlerësimi i rrethanave mbi ekzistencën ose jo të rrezikuar për "helmimin" e provave, bëhet rast pas rasti. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohet verifikimi që i bën gjykata edhe rrethanës mbi kohën që ka kaluar nga çasti i vënies në dijeni të të pandehurit për procedimin penal në ngarkim të tij, në lidhje me rrethanën nëse ka kryer apo mund të kryejë ndonjë veprim a sjellje që "rrezikon" procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provës.

Në këtë kontekst, në parim, edhe e drejta e heshtjes së të pandehurit, si një strategji mbrojtjeje e tij, nuk përbën në vetvete "rrezik" që mund të shërbejë si motiv për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe kjo rrethanë mund të vlerësohet në harmoni dhe në lidhje me sjelljet e tjera të tij ndaj veprës që ka kryer dhe procedimit penal të filluar, të cilat mund ta çojnë gjykatën në bindjen se ekziston dyshim i bazuar në prova se i pandehuri nëse lihet i lirë, do të helmojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës, nga ana e të gjykuarit.

10. Më tej, sikurse sipër citohet, në shkronjën "b' të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasti (kushti) "*kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet"*.

Në lidhje me këtë kusht për caktimin e masës së sigurimit, ndërkohë që "ikja", "largimi" i të pandehurit është çështje fakti, ka vend të evidentohet që pranimi nga gjykata i ekzistencës së mundësisë, pra "rrezikut të largimit", duhet të jetë më i motivuar, i mbështetur në elemente konkrete, në fakte e rrethana objektive.

Interpretimi i drejtë i dispozitës së shkronjës "b" të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale i sjell Kolegjet e Bashkuara në përfundimin unifikues se ***"rreziku i largimit", krahas elementeve të tjera, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj. Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja "b" nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit.***

Për efekt të motivimit të caktimit të masës së sigurimit, një nga rastet që përbën element objektiv për ta sjellë gjykatën në përfundime mbi largimin dhe rrezikun e largimit, është edhe gjendja e ikjes pa lënë gjurmë (fshehjes) të të pandehurit. Kjo gjendje, në vetvete, mishëron logjikisht e juridikisht prirjen e të pandehurit për të shkelur dhe mos zbatuar masat e sigurimit (përfshi arrestin në burg), qenien e tij në mënyrë permanente në pozitën e mosbindjes së paligjshme përballë ligjit, prirjen për t'iu shmangur hetimit dhe gjykimit, si dhe vuajtjes së dënimit. Kjo gjendje rreziku normalisht mbetet e tillë edhe nëse i pandehuri i deklaruar i ikur, më pas, tregon disponibilitetin e tij që të paraqitet apo kur paraqitet vullnetarisht para organeve të procedimit.

Një nga arsyet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet, por t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.

Masa e sigurimit e vendosur në çdo fazë të procedimit nuk ka lidhje as me të drejtën e të pandehurit që të mos paraqitet personalisht në seancë, apo që të largohet prej saj sipas vullnetit të tij të lirë. Nevojat e sigurimit vendosen për qëllime të tjera, ato nuk kanë asnjë lidhje dhe ndikim në lejimin apo kufizimin e së drejtës së të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin që zhvillohet ndaj

tij. Të pandehurit, me ose pa masë sigurimi, i garantohet e drejta për të marrë pjesë në gjykimin e akuzës kundër tij. Nëse çmon të mos marrë pjesë në seancë gjyqësore, ai është i lirë të mos paraqitet apo të largohet nga salla, por nëse është me masë sigurimi arrest në shtëpi apo në burg, i pandehuri detyrimisht qëndron apo kthehet në vendin e izolimit të tij.

Prandaj, në këtë kuptim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se duhet të theksohet që, largim sipas kuptimit të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 228 përbën edhe rrethana kur i pandehuri është larguar, transferuar e qëndron jashtë shtetit dhe me një sjellje të tillë duket se synon që ai t'i shmanget ushtrimit të juridiksionit penal shqiptar. Ky përfundim vlen edhe nëse pretendohet në gjykim se adresa e të pandehurit në shtetin tjetër është e njohur, përderisa largimi si sjellje nuk nënkupton vetvetiu edhe fshehjen e identitetit apo të adresës së qëndrimit nga ana e të pandehurit. Ky përfundim vlen gjithashtu edhe në rastin kur transferimi e largimi jashtë shtetit kanë ndodhur përpara se të fillohej procedimi penal ndaj këtij subjekti. Sikurse vlen edhe në rastin kur largimi i personit nga vendbanimi i njohur në drejtim të paditur brenda vendit apo jashtë vendit ka ndodhur përpara fillimit të procedimit penal. Sjellje të tilla, në thelb, përbëjnë shmangie të autorit të veprës nga ushtrimi i juridiksionit penal shqiptar.

Gjithashtu, për efekt të disponimit për caktimin e masës së sigurimit, edhe rrethanat e fshehjes apo kamuflimit të identitetit, tërheqja e fshehja e pasurive dhe sasive të konsiderueshme monetare apo transferimi i tyre jashtë vendit, janë elemente objektive konkrete, të cilat, në lidhje edhe me rrethana të tjera, mund të krijojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, pra bindjen se i pandehuri ka rrezik të largohet.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, vlen të evidentohet situata kur është ushtruar apo përfituar nga i pandehuri e drejta e azilit në një shtet tjetër, si një e drejtë e lirisë së shprehjes (politike) në një shoqëri demokratike. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se e drejta e azilit lidhet dhe mbetet e lidhur vetëm në marrëdhëniet që krijohen mes refugjatit dhe shtetit të huaj pritës. Por kjo gjendje, këto marrëdhënie nuk ndikojnë aspak në marrëdhëniet dhe çështjet e mëparshme apo në vijim që ekzistojnë mes këtij subjekti dhe shtetit të tij të origjinës, pra nuk pengojnë ushtrimin ligjor të autoritetit të shtetit të origjinës për ta hetuar, gjykuar dhe eventualisht dënuar atë.

Azilanti, për shtetin e origjinës, mbetet një i pandehur në gjendjen e personit të ikur, të larguar (pra jo në atë të rrezikut për t'u larguar), përderisa ai i fshihet drejtësisë së vendit të origjinës, përfshirë edhe gjykimit e zbatimit ndaj tij të masave të sigurimit, mes të tjerave, të justifikueshme pikërisht edhe për shkak të largimit të tij jashtë shtetit. Kjo gjendje është e kuptueshme se e tejkalon edhe konceptin, kriterin e "rrezikut të largimit", edhe kjo në vetvete e mjaftueshme për të zbatuar masën e sigurimit që synon të evitojë që i pandehuri dhe, më pas, eventualisht, i dënuari t'i shmanget gjykimit dhe vuajtjes së dënimit përfundimtar.

11. Në shkronjën "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasti (kushti) "*kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet"*.

Përmbajtja e dispozitës së sipërcituar të shkronjës "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhet me nevojën për caktimin e masës së sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit për garantimin e rendit e të sigurisë publike, paprekshmërinë e jetës, shëndetit, pronës dhe interesave e të drejtave të tjera të ligjshme nga kryerja e veprave të tjera penale nga ana e të pandehurit. Në këtë aspekt, për të legjitimuar kufizimin e lirisë së të pandehurit, pra caktimin e masës së sigurimit, mes të tjerave, objekti i gjykimit është verifikimi i rrethanave konkrete të faktit të cilat i shërbejnë gjykatës për të vlerësuar e konkluduar mbi rrezikshmërinë e autorit dhe, nga ana tjetër, për të përcaktuar veprat penale që ka rrezik të kryhen prej tij.

Në këtë kuptim, për pranimin e ekzistencës së nevojës së sigurimit, të rrezikut konkret për komunitetin, cenimin e rendit dhe të sigurisë publike, të cilat justifikojnë caktimin e masës së sigurimit sipas kësaj dispozite, objekt i hetimit gjyqësor duhet të jetë vlerësimi konkret i rrethanave

të faktit, duke nxjerrë nga sjellja në tërësi e të gjykuarit elemente konkrete të vlefshme për të bazuar dhënien e vendimit.

Sikurse për rastet e rrezikut për "eliminimin" e provave dhe atij të ikjes, edhe në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, ***nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të së pandehurit, nëse ka precedentë penalë, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij.***

Bazuar në vlerësimin e provave mbi ekzistencën e elementeve konkrete të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të së gjykuarit, jo domosdoshmërisht kumulative, gjykata nxjerr përfundimin nëse ekziston dyshim i arsyeshëm mbi rrezikshmërinë e tij dhe nevojën për të garantuar paprekshmërinë e komunitetit, nëse ekziston mundësia reale që i gjykuari, në të ardhmen, duke qenë në gjendje të lirë, mund të kryejë vepra penale të rënda apo të të njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar.

"Krimet e rënda", në kuptim të shkronjës "c" të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, nuk përfshijnë vetëm ato për të cilat ka kompetencën Gjykata për Krime të Rënda, por edhe vepra të tjera penale të rënda, të cilat, për vetë rrezikshmërinë dhe pasojat e tyre, janë pranuar si të tilla në praktikën tonë gjyqësore edhe para krijimit të këtyre gjykatave.

12. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

"*1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.*

2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal".

Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprës penale prej tij dhe, nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshme, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilat tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkalla e rrezikut, së paku sipas njërit prej rasteve të nenit 228.

Si në rastin kur masa e sigurimit caktohet për herë të parë, ashtu edhe kur shqyrtohet zëvendësimi i masës ekzistuese, gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme. Në çdo rast mbetet detyrimi i gjykatës që, fillimisht, të argumentojë se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova në ngarkim të të gjykuarit për kryerjen nga ana e tij të veprës penale.

Prandaj, edhe në rastin kur vendos caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, gjykata nuk ka detyrim të analizojë në hollësi përse llojet e masave të tjera nuk janë të përshtatshme në çështjen në gjykim. Bazuar në elementet objektive mbi natyrën dhe llojin e veprës penale, mjetet dhe mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e shkaktuara, si dhe në elementet subjektive të lidhura me personalitetin e të gjykuarit dhe gjendjen e rrezikut, gjykata argumenton se masa e vetme e përshtatshme ndaj të gjykuarit në raport me llojin dhe shkallën e rrezikut është ajo e arrestit në burg.

Në rastin e procedimeve penale për kryerjen e krimeve të rënda apo që kanë sjellë pasoja të rënda, për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë se autorit të tyre sipas nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale. Masa e sigurimit arrest në burg e kërkuar nga prokurori ndaj të gjykuarit mund të çmohet nga gjykata si e papërshtatshme, vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg.

13. Në pikën 1 të nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

"1. *Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa"*.

Së pari, nga përmbajtja e saj del qartë se qëllimi i ligjvënësit është të urdhërojë se masa e sigurimit caktohet vetëm nga gjykata. Gjykata nuk disponon kryesisht, pra masa nuk caktohet nëse nuk paraqitet kërkesë nga prokurori, e cila duhet të jetë e mbështetur në prova dhe në ligj.

Së dyti, kërkesa duhet t'i paraqitet *gjykatës kompetente*. Kjo dispozitë gjendet në pjesën e parë, titullin V, kreu II. Pra, jo vetëm nga vendi ku gjendet në Kodin e Procedurës Penale (përpara titujve mbi fazën e hetimit paraprak dhe atij të gjykimit), por edhe nga përmbajtja e saj, kjo dispozitë thjesht evidenton se duhet respektuar parimi procedural i disponimit nga organi që procedon.

Pa dyshim që, në fazën e gjykimit, i vetmi organ që procedon me çështjen penale të dërguar për gjykim, pra edhe për caktimin e masës së sigurimit, revokimin e zëvendësimin e saj, është gjykata, pikërisht vetëm ajo gjykatë e cila është caktuar për gjykimin e veprës penale deri në dhënien e vendimit të pushimit, pafajësisë apo dënimit.

Kodi i Procedurës Penale, në pikën 1 të nenit 13, parashikon gjykatat të cilat gjykojnë veprat penale. Ndërsa në pikën 2, përcaktohet se me përbërje monokratike gjykohen kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, ku bëjnë pjesë edhe disponimet lidhur me masat e sigurimit.

Dispozita e pikës 2 nuk tregon se kush disponon për kërkesa të palëve lidhur me masa sigurimi në fazën e gjykimit, as për përbërjen e gjykatës. Kjo nuk është e rastit dhe as ndonjë ometim nga ana e ligjvënësit. Qëllimi i këtyre dispozitave nuk është të tregojnë a kufizojnë ushtrimin e së drejtës së paraqitjes të kërkesave të palëve apo ushtrimin e kompetencës së gjykatës mbi masat e sigurimit vetëm në fazën e hetimit apo edhe në atë të gjykimit. Dispozita thjesht tregon që, nëse kërkesat paraqiten në fazën e hetimit, vendos gjykata monokratike, e njëjta gjykatë që gjatë hetimit, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, disponon edhe për ecurinë e zbatimit të masës së sigurimit.

Por edhe neni 246 nuk shprehet dhe nuk e lidh zbatimin e urdhërimeve të saj vetëm me fazën e hetimit, sepse, gjatë fazës së gjykimit, është gjykata e themelit që vlerëson situatën e zbatimit të masës së sigurimit të caktuar më parë gjatë hetimit paraprak apo në fazën e gjykimit.

Ndërkohë që, edhe kuptimi e zbatimi i dispozitave të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale nuk lidhet me ndonjë fazë gjykimi, por gjejnë zbatim kurdoherë "*kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit*" të një mase sigurimi të caktuar më parë. Madje pika 4 e këtij neni tregon qartë se për revokimin a zëvendësimin e masës ekzistuese disponon, jo vetëm gjyqtari i hetimit paraprak, por, në varësi të fazës së procedimit, edhe e njëjta gjykatë, pra ajo që shqyrton kërkesën për gjykim dhe zgjidh përfundimisht në themel çështjen. As kjo dispozitë nuk tregon apo urdhëron se masat e sigurimit caktohen vetëm në fazën e hetimit paraprak.

Në titullin V të Kodit të Procedurës Penale "*Masat e sigurimit*" parashikohen rregulla mbi kushtet dhe kriteret e paraqitjes së kërkesës dhe të disponimit të gjykatës lidhur me masat e sigurimit. Dispozitat e këtij titulli nuk përmbajnë ndonjë rregullim specifik lidhur me *gjykatën kompetente* për shqyrtimin e kërkesave për masat e sigurimit, as edhe ndonjë rregullim mbi lejimin

apo ndalimin e shqyrtimit të kërkesave mbi këto masa nga gjykata në fazën e hetimit paraprak apo në fazën e gjykimit.

Po kështu, ky Kod, në dispozitat vijuese, sikurse edhe në titullin VII "Gjykimi" dhe në dispozitat në vijim nuk përmban ndonjë rregullim konkret me të cilën të shprehet lidhur me paraqitjen e kërkesave dhe ankesave lidhur me caktimin, revokimin, zëvendësimin, etj., të masave të sigurimit, mbi kompetencën dhe përbërjen e gjykatës, mënyrën e disponimit të saj në rastin e shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave.

Nëse është paraqitur kërkesa për gjykim, i përket vetëm gjykatës së caktuar për shqyrtimin e saj dhe asnjë gjykate a gjyqtari tjetër kompetenca që të vendosë caktimin, zëvendësimin a revokimin e masave të sigurimit.

Me depozitimin e kërkesës për gjykim, gjyqtari i fazës së hetimeve paraprake (i njëjti gjyqtar për të gjitha kërkesat) vetvetiu ka humbur kompetencën e tij për të trajtuar kërkesa lidhur me masat e sigurimit dhe çdo lloj kërkese tjetër të palëve për të cilat kompetente është gjykata. Ajo i ka kaluar gjykatës së caktuar për shqyrtimin e kërkesës për gjykim.

Gjyqtari që ka dhënë vendimin e dënimit mbetet kompetent lidhur me masat e sigurimit edhe në periudhën deri kur, mbi ankimin e palës, çështja të jetë regjistruar në gjykatën e apelit. Në thelb gjykata e apelit nuk mund të shqyrtojë një kërkesë lidhur me masat e sigurimit, për sa kohë nuk i është depozituar dhe nuk ka regjistruar çështjen për shqyrtim në apel. Deri në atë moment vendos gjyqtari që ka dhënë vendimin e dënimit. Në pamundësi objektive për të njëjtin gjyqtar, gjithsesi vendos një gjyqtar tjetër i po asaj gjykate ku është dhënë vendimi i dënimit.

Nga ana tjetër, nga interpretimi i drejtë i përmbajtjes së dispozitave kushtetuese (nenet 27 e 28) dhe atyre të Kodit të Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se vullneti i ligjvënësit, qëllimi i caktimit të masave të sigurimit dhe efektet e zbatimit të tyre nuk dallojnë e nuk ndryshojnë nga fakti se në cilën fazë të procedimit ato caktohen apo nga gjykata dhe përbërja e gjykatës që ka dhënë vendimin lidhur me to. Masat e sigurimit personal nuk përbëjnë në vetvete akte të hetimit dhe të marrjes së provës dhe as nuk lidhen me fillimin e përfundimin e afateve të hetimit paraprak e pasojat përkatëse. Prandaj është e ligjshme që masat e sigurimit të caktohen, revokohen apo zëvendësohen nga gjykatat edhe pas përfundimit të fazës së hetimit paraprak sepse si gjykatë që procedon, pra si gjykata që ka disponibilitetin e akteve është gjykata që shqyrton kërkesën për gjykim. Kështu që, me paraqitjen e kërkesës për gjykim, kompetenca për të disponuar mbi kërkesat e ankesat lidhur me masat e sigurimit kalon *ipso iure* tek gjykata që e shqyrton themelin e akuzës.

Prandaj, bazuar në analizën dhe interpretimin e normave më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se ***ligjvënësi nuk ka vendosur ndonjë kufizim lidhur me të drejtën e palëve për të paraqitur kërkesa lidhur me masat e sigurimit, përfshirë atë për caktimin e saj për herë të parë në gjykim, as edhe për gjykatën që procedon (në fazën e hetimit paraprak apo në atë të gjykimit), lidhur me atë kërkesë. Pra, masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, nëse janë nevojat e sigurimit, nëse nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji nenet 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.***

Parimi i përgjithshëm procedural penal është që lidhur me çështjet, kërkesat e ankesat e palëve, apo atyre që çmohen kryesisht, kompetencën për të vendosur e ka organi që procedon. Organi që procedon dhe ka disponimin e akteve të çështjes në fazën e hetimit paraprak është prokurori, ndërsa në fazën e gjykimit është gjykata.

Përjashtimisht, ligji përcakton se në fazën e hetimit paraprak, ndonëse mbi çështjen dhe aktet vlerëson e disponon prokurori, në rastin e masës së sigurimit, për shkak se ato lidhen me kufizimin e lirisë së individit, vendimin për caktimin ose jo të saj, si dhe për revokimin a zëvendësimin e masës, e bën gjyqtari monokratik i hetimit paraprak. Por kur është paraqitur kërkesa

për gjykim, mbi aktet e çështjes disponon pa asnjë përjashtim dhe ekskluzivisht e njëjta gjykatë, gjykata e themelit (monokratike a kolegjiale) që ka kompetencën lëndore e tokësore të shqyrtimit në themel të çështjes.

Në të gjitha rastet, investimi e disponimi i gjykatës nuk përbën paragjykim e rrjedhimisht njëanshmëri të gjykatës drejt një vendimi dënimi (fajësie), pushimi apo pafajësie sepse qëllimi, natyra dhe kriteret ligjore të gjykimit dhe motivimit të vendimit për caktimin e masës së sigurimit janë të ndryshme nga ai për zgjidhjen në themel sipas neneve 387 deri 399 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo njëanshmëri nuk ekziston, si në rastin kur gjykata cakton masën e sigurimit, ashtu edhe kur e revokon apo zëvendëson me një masë tjetër, më të lehtë ose më të rëndë. Përkatësisht nuk ka vend për paragjykim të qëndrimit të gjykatës në lidhje me akuzën si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.

Lehtësimi apo rëndimi i masës së sigurimit, si pjesë e kuptimit dhe e zbatimit të ligjit procedural penal, nuk ka lidhje as me parimin e mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit, sepse ky parim gjen zbatim vetëm në kuptimin e zbatimin e ligjit penal material. Njëra nga situatat që afirmon këtë është pika 3 e nenit 260, ku parashikohet që kur nevojat e sigurimit rëndohen, gjykata zëvendëson masën e zbatuar me një tjetër më të rëndë. Madje këtë e bën jo vetëm me kërkesën e prokurorit por, aq më tepër, edhe kryesisht, kur e çmon se është rasti.

Nuk kemi njëanshmëri edhe për faktin e thjeshtë që këtë kompetencë të gjykatës së themelit e parashikon vetë ligji, kur i jep asaj detyrën për të vendosur edhe revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit me një më të lehtë apo më të rëndë. Madje ligji e lejon gjykatën të vendosë edhe kryesisht (neni 260).

I vetmi kufizim procedural, i parashikuar shprehimisht nga ligji, gjendet në pikën 2 të nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilën parashikohet se nuk mund të marrë pjesë në gjykim (pra në fazën e gjykimit) gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit, apo çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim. Nga ana tjetër, ligji procedural obligon që të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.

Vetëm për heqjen dorë apo mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit apo anëtarit të trupit gjykues, vetë ligji procedural parashikon shprehimisht e përjashtimisht se disponon një gjyqtar apo trupë tjetër gjykuese (nenet 17, pika 2 dhe 21). Kjo për arsyen e thjeshtë se vetë ligji procedural e pengon këtë gjyqtar të procedojë me tej me çështjen dhe të disponojë me vendime derisa të shprehet gjykata tjetër për përjashtimin ose jo të tij nga ajo çështje (neni 18, pika 2).

14. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se nuk përjashtohet mundësia që, sipas rrethanave konkrete të ecurisë së një procedimi penal, gjykata të caktojë masë sigurimi ndaj personit në hetim apo të pandehurit, edhe pse masa e mëparshme e dhënë ndaj tij ishte shuar apo revokuar më parë nga gjykata.

Kështu, në rastet kur vendimi për caktimin e masës së sigurimit është çmuar më pas nga gjykata si i pavlefshëm, pra thjesht për shkelje formale procedurale (p.sh. për mungesë të nënshkrimit nga gjyqtari), apo kur kjo masë është shuar për shkak të pushimit të çështjes në fazën e hetimit paraprak (p.sh. neni 261, pika 1), nuk ka asnjë logjikë juridike për të përjashtuar mundësinë që masa e sigurimit të mund të caktohet sërish nga gjykata në çdo fazë të procedimit, për të njëjtat rrethana të faktit e të ligjit lidhur me nevojat e sigurisë për të cilat ajo ishte vendosur. Ajo vendoset me kërkesën e prokurorit dhe nëse përmbushen kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji.

Në këto raste nuk shkelet parimi *ne bis in idem* në shqyrtimin dhe disponimin e gjykatës mbi masat e sigurimit. Por, në zbatim të këtij parimi, kërkesa e prokurorit për caktimin sërish të masës së sigurimit nuk pranohet nga gjykata, në rast se është motivuar mbi të njëjtat rrethana të faktit e të ligjit, të cilat nga gjykata janë vlerësuar njëherë si motive për të shuar, revokuar apo ndryshuar vendimin e mëparshëm për caktimin e masës ndaj të gjykuarit, i cili ka marrë formë të prerë.

Prokurori ose i pandehuri që kanë paraqitur kërkesë për caktimin, revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit, kanë barrën e provës të argumentojnë para gjykatës se kanë lindur apo ndryshuar nevojat e sigurimit apo rrethanat e faktit lidhur me të.

Është thelbësore të mbahet parasysh se, në zbatim të drejtë të ligjit, në rastin e masave të sigurimit, vlera e gjësë së gjykuar ka natyrë relative, në kuptimin që ajo lidhet vetëm me parimin e garantimit të nevojave të sigurimit, rrjedhimisht me rrethanat e faktit e të ligjit, të cilat ekzistonin në çastin e dhënies së vendimit gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit.

Nëse ndryshojnë nevojat e sigurimit, pra nëse rrethanat ndryshojnë, gjykata mund të revokojë ose ndryshojë masën e dhënë më parë (neni 260), apo të caktojë një masë të re nëse lind përsëri nevoja e sigurimit.

Prandaj, në vështrim të interpretimit të ligjit procedural penal të parashtruar më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se ***masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, sa herë që nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet paraprake dhe kriteret e rrezikut të parashikuara nga nenet 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Kjo gjendje "rreziku" mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Vendimi lidhur me caktimin e masës së sigurimit apo për zëvendësimin, revokimin e shuarjen e saj jepet për gjendjen në të cilin është procedimi, për gjendjen në të cilën janë aktet, për rrethanat e faktit e të ligjit në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe shqyrtimit të saj nga gjykata.***

Ndonëse për vetë natyrën dhe mënyrën e zhvillimit të një procedimi penal, masat e sigurimit normalisht e zakonisht caktohen në fazën e hetimit paraprak, nuk ka asnjë logjikë juridike apo pengesë ligjore që këto masa të mos caktohen për herë të parë edhe në fazën e gjykimit. Nëse ekzistojnë nevojat e sigurimit, të cilat, sikurse edhe respektimi i lirisë së individit, janë garanci e detyrime që burojnë nga Kushtetuta, pra nëse janë kushtet paraprake dhe verifikohen rrethanat e rrezikut të parashikuara nga ligji, jo vetëm që nuk është pengesë, por përkundrazi, është detyrim për gjykatën që të pranojë kërkesën e prokurorit dhe të caktojë masën e sigurimit. Qëllimi dhe efektet e parashikuara nga ligji procedural penal për masën e sigurimit, koncepti juridik i "rrezikut" dhe parimi i "përshtatshmërisë" për caktimin dhe zbatimin e saj, qëndrojnë dhe i shërbejnë njësoj, si fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe asaj të gjykimit.

15. Duke pasur parasysh arsyetimin mbi interpretimin dhe unifikimin e ligjit procedural penal të parashtruar më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit e përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur mbrojtësi i të pandehurit Ilir Kumbaro nuk janë të mbështetura në ligj.

Gjykata për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, bazuar në aktet që përmbahen në fashikullin e gjykimit dhe nga provat e tjera të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor e të paraqitura nga palët, kanë arsyetuar e pranuar se ekziston një fakt kriminal dhe ka dyshime të arsyeshme në drejtim të pjesëmarrjes së të pandehurit Ilir Kumbaro në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë në kryerjen e veprimit kriminal, shoqërimin e paligjshëm, rrëmbimin dhe kryerjen e keqtrajtimeve fizike dhe torturave ndaj shtetasit maqedonas me kombësi shqiptare Remzi Hoxha dhe të dëmtuarve Avni Koldashi, Ziso Kristopulli duke përdorur mjetet dhe objektet shtetërore në Vain të rrethit të Lezhës dhe Tiranë.

Mbi këto rrethana dhe për identifikimin e autorëve të mundshëm të veprimit kriminal, veç të tjerave, kanë dhënë deklarimet e tyre të dëmtuarit Avni Koldashi dhe Ziso Kristopulli. Ndërsa rreth shtetasit maqedonas me kombësi shqiptare Remzi Hoxha, përveç atyre mbi faktin se ushtronte veprimtari në Tiranë nga ku u rrëmbye dhe izolimit e keqtrajtimit në Vain të Lezhës, me gjithë përpjekjet e kërkimet e familjarëve të tij dhe autoriteteve, nuk ka asnjë të dhënë nëse është liruar dhe nëse ende jeton.

I pandehuri Ilir Kumbaro në periudhën e ngjarjes kishte detyrën e Kryetarit të Degës së Parë në Drejtorinë e Tiranës të Shërbimit Informativ Kombëtar, duke marrë pjesë drejtpërdrejt në shoqërimin e paligjshëm të të dëmtuarve dhe shtetasit Remzi Hoxha.

Prandaj, Gjykata për Krime të Rënda ka ardhur në përfundimin se, mbështetur në dyshimet e arsyeshme të bazuara në prova, se i pandehuri Kumbaro, në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, kanë kryer veprat penale të rënda dhe me pasoja të rënda, sikurse janë "rrëmbimi ose mbajtja peng e personit" dhe "tortura me pasoja të rënda" sipas neneve 109/1 e 25 dhe 87 e 25 të Kodit Penal.

I pandehuri Kumbaro, në dijeni të procedimit penal ndaj tij, vijon t'i fshihet drejtësisë me qëllim shmangien nga hetimi dhe gjykimit ndaj tij, duke qëndruar jashtë shtetit dhe duke ndërruar identitetin e tij duke përdorur dokumente të një shtetasi kosovar. Ndërkohë që personaliteti dhe sjellja e tij tregojnë se ka rrezik që të kryejë krime të rënda.

Në rrethana të tilla, Gjykata për Krime të Rënda ka vlerësuar se gjendet përpara kushteve e kritereve të parashikuara nga nenet 228, pika 3, shkronja "b" e "c" dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, për rrjedhojë ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg, e parashikuar nga neni 238 e këtij Kodi.

Masa e sigurimit arrest në burg ndaj të pandehurit Ilir Kumbaro e caktuar nga Gjykata për Krimet e Rënda, me një arsyetim të ngjashëm, është miratuar edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

16. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se të dyja gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin procedural penal duke pranuar kërkesën e prokurorit dhe caktuar për të pandehurin Kumbaro masën e sigurimit arrest në burg.

Të dyja vendimet gjyqësore, duke respektuar kërkesat e ligjit procedural penal, mbështesin arsyetimet e tyre jo në konstatime të përgjithshme, por në prova që tregojnë rrethanat konkrete të faktit e të ligjit të analizuara prej tyre, të cilat i kanë sjellë me të drejtë ato në dyshimin e arsyeshëm se veprat penale janë kryer nga i pandehuri Ilir Kumbaro në bashkëpunim me të tjerë.

Drejt kanë evidentuar gjykatat rrethanën që i pandehuri i fshihet drejtësisë, hetimit dhe gjykimit të tij duke u larguar e qëndruar jashtë vendit, duke ndërruar për këtë qëllim edhe identitet, të cilin ia ka marrë një shtetasi kosovar. Kjo rrethanë identifikohet me kriterin e parashikuar nga shkronja "b" e pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit.

Njëkohësisht drejt kanë evidentuar gjykatat edhe rrethanën që personaliteti i të pandehurit, si ish-funksionar i lartë dhe aktiv i shërbimit sekret, si dhe sjellja e tij para e pas ngjarjes dhe procedimit ndaj tij, tregojnë se ai ka rrezik të kryejë krime të tjera të rënda, rrethanë e cila identifikohet me kriterin e parashikuar nga shkronja "c" e pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit.

Po kështu, veprat penale që i atribuohen të pandehurit Kumbaro janë të rënda, sikurse edhe pasojat janë të rënda, pra rrëmbim personi dhe tortura me pasoja të rënda ndaj tre personave. Me të drejtë, kjo e ka sjellë gjykatën në përfundimin që është vendi për të zbatuar kriteret e nenit 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, nisur nga rrezikshmëria e veçantë e veprave penale dhe sanksioneve mbi 10 vjet heqje lirie.

Akuza për kryerje të krimeve të rënda dhe që kanë sjellë pasoja të rënda, në bashkëpunim me të tjerë, duke pasur parasysh personalitetin e tij dhe sjelljen para e pas ngjarjes dhe shmangia permanente nga hetimi e gjykimi, të sjellin në konkluzion ligjor se e vetmja masë sigurimi e përshtatshme për të pandehurin Ilir Kumbaro është ajo e arrestit në burg.

17. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se nuk qëndron pretendimi i ngritur në rekurs nga mbrojtësi i të pandehurit Ilir Kumbaro mbi mohimin nga Gjykata për Krimet e Rënda të së drejtës së të pandehurit për t'u mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij dhe duke e zhvilluar padrejtësisht seancën për caktimin e masës së sigurimit me një mbrojtës të caktuar kryesisht.

Kolegjet vërejnë se i pandehuri Ilir Kumbaro mbrohej nga dy avokatë. Njoftimet për vendin dhe kohën e zhvillimit të seancës gjyqësore pasardhëse ndaj dy mbrojtësve së të pandehurit janë kryer rregullisht nga gjykata.

Ndërsa njoftimi i mëvonshëm nga mbrojtësit për pamundësinë e paraqitjes në seancë gjyqësore për shkak të nevojës së pjesëmarrjes në një gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas Kolegjeve të Bashkuara nuk justifikon mungesën e të dy avokatëve në seancën gjyqësore ku u shqyrtua kërkesa e prokurorit dhe u caktua masa e sigurimit arrest në burg për të mbrojturin prej tyre, të pandehurin Ilir Kumbaro.

Garantimi i mbrojtjes së të gjykuarit në procesin penal dhe prania e mbrojtësit në gjykim janë garanci kushtetuese dhe ligjore për të, si person nën hetim apo i pandehur. Nëse është caktuar nga i pandehuri apo gjykata kryesisht, detyrimi kushtetues e ligjor i mbrojtësit është që të sigurojë pjesëmarrjen e tij në veprimet procedurale dhe në seanca gjyqësore, si dhe të kryejë efektivisht dhe me profesionalizëm veprimet, kërkesat, ankesat, etj., në interes të së mbrojturit prej tij.

Mbrojtësi ka edhe detyrimin kushtetues që të marrë të gjitha masat që varen nga vullneti dhe kontrolli i tij për të mos munguar në kryerjen e veprimeve dhe në seanca gjyqësore për mbrojtjen e interesave të klientit të tij. Mungesa e tyre është e justifikuar vetëm nëse ka pengesa apo gjendet në pamundësi për të realizuar mbrojtjen e klientit të tij, për shkaqe të pavarura prej tij, të tilla që e bëjnë objektivisht të pamundur të përmbushë detyrën e mbrojtësit, sikurse janë rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme dhe fatkeqësive natyrore, ngjarje aksidentale mbi personin e tij apo familjarë të tij, raste fatkeqësie në rrethin më të afërt familjar, gjendja shëndetësore personale e tillë që pamundëson kryerjen e detyrës apo gjendja shëndetësore e rëndë e familjarëve të tij nëse evidentohet domosdoshmëria e pranisë së tij tek i sëmuri.

Nuk përbën justifikim të pranueshëm ligjërisht pretendimi i mospjesëmarrjes në kryerjen e veprimit procedural apo në seancë gjyqësore, kur avokati njofton se ndodhet në kryerjen e një veprimi procedural për një klient tjetër në një çështje tjetër, ose në një gjykim tjetër, ndodhet jashtë qendrës së autoritetit procedues apo jashtë shtetit për motive profesionale apo çlodhëse e zbavitëse, etj.

Nëse, nga njëra anë, është e drejta e të gjykuarit të ketë mbrojtës, nëse është detyrim i gjykatës të sigurohet që i gjykuari ka mbrojtës të caktuar prej tij e nëse nuk ka a mungon t'ia sigurojë një tjetër kryesisht dhe se mbrojtësit e ushtrojnë profesionalisht dhe efektivisht detyrën e tyre, nga ana tjetër, është detyrimi ligjor i mbrojtësve të marrin masa për të siguruar pjesëmarrjen në hetim apo gjykim dhe, nëse e kanë të pamundur, jo vetëm të njoftojnë gjykatën, por edhe të mbrojturin prej tij për pengesën e pamundësinë për të ushtruar mbrojtjen.

Në këtë kontekst, nuk ka logjikë juridike për të justifikuar mungesën e mbrojtësit, me arsyetimin se gjendet në një proces tjetër. Përfshirja e avokatit në mbrojtjen e klientëve në procedime të ndryshme dhe ngarkesa e tij me punë janë zgjedhja e tij, sikurse është edhe vijimi i realizimit të mbrojtjes apo heqja dorë nga mbrojtja. Pranimi i ushtrimit të detyrës dhe heqja dorë prej saj nga mbrojtësi janë akte të vullnetit të tij dhe plotësisht të kontrollueshme prej tij. Si të tilla është detyrimi i avokatit të marrë masa organizative për të bashkëpunuar me kolegë të tjerë, apo për të mbajtur aq ngarkesë pune sa mund të garantojë klientët dhe autoritetet gjyqësore se është në gjendje të përmbushë detyrën. Nuk janë gjykatat ato që duhet të zgjidhin problemet e ngarkesës me punë të avokatëve, sikurse nuk është çështje e avokatëve të zgjidhin problematikën e ngarkesës së punës së gjykatës.

Po kështu, secili procedim, çdo gjykim ka të njëjtën standard dhe të njëjtën rëndësi për dhënien e drejtësisë dhe procesin e rregullt ligjor. Secila gjykatë ka detyrimin t'i përmbahet këtyre standardeve. Nuk është avokati ai që "zgjedh" se cila gjykatë duhet të vijojë me praninë e tij dhe cila të shtyjë gjykimin, as edhe përcakton ai se cili prej gjykimeve është më i rëndësishëm se tjetri.

Nëse avokati është i ngarkuar me shumë çështje, nëse gjendet para angazhimit të njëkohshëm në dy gjykime të ndryshme, detyra e tij është të njoftojë mospjesëmarrjen dhe shkakun përkatës. Gjykata nuk ka detyrim për të shtyrë seancën, por ka detyrimin tjetër që, nëse e kërkon ligji, t'i sigurojë të gjykuarit një mbrojtës kryesisht.

Nisur nga sa arsyetohet më sipër, pretendimi i mbrojtjes se ka njoftuar gjykatën për pjesëmarrje në një gjykim tjetër nuk është i mbështetur në ligj. Aq më tepër në çështjen objekt gjykimi, kur i pandehuri Ilir Kumbaro mbrohej nga dy avokatë, madje si pjesë e një studioje ligjore. Gjykatat kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor, duke i caktuar të pandehurit një mbrojtës tjetër kryesisht, duke i dhënë atij edhe kohën e nevojshme për t'u përgatitur dhe duke zhvilluar gjykimin në atë seancë gjyqësore me praninë dhe pjesëmarrjen (mbrojtjen) efektive të këtij avokati.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të nenit 438 dhe të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të shkronjës "a" të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë*",

VENDOSËN:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.5, datë 5.1.2010 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njëson praktikën gjyqësore.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese), Aleksandër Muskaj, Ardian Dvorani, Evelina Qirjako, Arjana Fullani, Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi

Anëtarë kundër: Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Andi Çeliku, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj.

MENDIMI I PAKICËS

Për vendimin nr.7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Ne gjyqtarët, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Majlinda Andrea, Fatos Lulo, Andi Çeliku e Guxim Zenelaj nuk jemi dakord me vendimin e marrë nga shumica, e cila ka konsideruar të drejtë e të bazuar në ligj vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, duke pranuar se masa e sigurimit personal mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e çështjes, nëse verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit. Ndryshe nga vendimi i shumicës, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.5, datë 5.1.2010 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, jemi të mendimit se si vendimi nr.5, datë 5.1.2010 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe vendimi nr.154, datë 15.12.2009 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë duheshin prishur dhe të rrëzohej kërkesa.

Pa dashur të përsërisim rrethanat e çështjes, të cilat janë trajtuar në vendimin e shumicës, do të argumentojmë më poshtë qëndrimin tonë kundër, mbështetur në dispozitat ligjore.

Shumica, pasi ka parashtruar sintetikisht faktet e administruara nga gjykatat e dy niveleve, ka arritur në përfundimin se vendimet ishin të bazuara në ligj dhe duheshin lënë në fuqi.

Jemi kundër pranimit nga ana e shumicës të pohimit të prokurorit në gjykimin e çështjes se sipas organit të akuzës, i pandehuri Ilir Kumbaro është hetuar në gjendje arresti në burg. Sipas organit të prokurorisë, masa e sigurimit arrest në burg ka ekzistuar për të si organ edhe pse ajo nuk ishte ekzekutuar, për shkak se i pandehuri nuk gjendej dhe për këtë shkak ishte deklaruar ikja e tij. Këtë qëndrim të prokurorisë e ka pranuar shumica në vendimin e saj, qëndrim që për ne gjyqtarët në pakicë është i papranueshëm.

Nuk mund të pranojmë se organi i prokurorisë ka menduar apo ka marrë të mirëqenë faktin se gjendja procedurale e të pandehurit deri në dërgimin e çështjes për gjykim ka qenë e një të pandehuri me masë sigurimi "arrest në burg". Kjo do të vinte në kundërshtim me ligjin procedural penal, në të cilin është sanksionuar se në rastet e pafajësisë apo të pushimit të çështjes hiqen edhe masat e sigurimit (neni 389 i Kodit të Procedurës Penale).

Në nenin 261 të Kodit të Procedurës Penale janë parashikuar rastet e shuarjes së masave të sigurimit dhe në pikën 1/a të këtij neni përcaktohet se: "*1. Masat e sigurimit shuhen: a) kur për të njëjtin person është vendosur* ***pushimi i çështjes*** *ose është dhënë vendimi i pafajësisë"*.

Në kushtet kur për të pandehurin Ilir Kumbaro, nga vetë prokurori i çështjes është vendosur me vendimin datë 1.7.2004 pushimi i çështjes, atëherë në këtë moment është shuar edhe masa e sigurimit arrest në burg e caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr.1229, datë 18.12.2003 për të pandehurin.

Nuk mund të pranohet që nga prokurori të bëhej i "padituri" për këtë fakt dhe të vazhdohej procedimi (hetimi i çështjes) pas shfuqizimit nga Prokurori i Përgjithshëm më datë 8.9.2006 (pas më shumë se 2 vjetësh nga pushimi) i vendimit të pushimit të çështjes, duke konsideruar se i pandehuri ishte me masë sigurimi.

Masa e sigurimit pas pushimit të çështjes dhe riçeljes së saj, nuk mund të rivihen në fuqi automatikisht, pa kërkesë të prokurorit, si personi i ngarkuar nga ligji me kryerjen e disa veprimeve procedurale gjatë hetimit, i cili mbikëqyr hetimin.

Pakica, në të kundërt me sa ka pranuar shumica në vendim, konkludon se i pandehuri Ilir Kumbaro është dërguar për gjykim pa masë sigurimi.

Që këtej lind pyetja: - A mund të caktohet masë sigurimi për një të pandehur me kërkesë të prokurorit në gjykim, kur i pandehuri është dërguar në gjykim pa masë sigurimi, pra është hetuar pa masë sigurimi? Në përgjigje të kësaj pyetjeje, shumica ka ardhur në përfundimin se masat e sigurimit mund të caktohen në çdo fazë të procedimit penal dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që këto masa të mos caktohen për herë të parë edhe në fazën e gjykimit.

Ndryshe nga përfundimi i shumicës, pakica është e mendimit se masa e sigurimit nuk mund të kërkohet të vendoset në fazën e gjykimit për herë të parë, nëse i pandehuri është dërguar në gjykim pa iu caktuar ndonjë masë sigurimi.

Edhe pse pakica është dakord me arsyetimin dhe interpretimin që shumica i bën pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, për kushtet kur vendosen masat e sigurimit, pakica çmon se vlen të theksohet se dispozita e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, ashtu si çdo dispozitë tjetër, lexohet e zbatohet që në fillim të saj.

Në pikën 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se: "*Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova*". Në interpretim të kësaj pike të nenit 228, çmojmë se që për një person të kërkohet të caktohet një masë sigurimi duhet të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm, objektiv, i krijuar dhe i mbështetur në prova. Pra bëhet fjalë për një person në ngarkim të të cilit ekziston dyshimi i bazuar në një sërë indiciesh e provash se ai është autor i një vepre penale. Por, kur një person është i dyshuar se ka kryer një vepër penale? Ai është i dyshuar gjatë fazës së hetimit të çështjes, pasi në momentin që çështja është dërguar për gjykim në gjykatë në ngarkim të të

pandehurit rëndon një akuzë përfundimtare, të cilën ia ka atribuar prokurori. Për prokurorin, i pandehuri, për të cilin është paraqitur kërkesa për gjykim përpara gjykatës, nuk është më një person i dyshuar, për të cilin ka pak indicie dhe prova, por për prokurorin mbi të pandehurin rëndon një akuzë dhe ekzistojnë prova të plota për të provuar fajësinë e tij. Për pakicën, masa e sigurimit është një veprim procedural që zbatohet në ngarkim të një personi, i cili është në hetim dhe dyshohet se ka kryer një vepër penale.

Organi i akuzës kërkon caktimin e një mase sigurimi për të garantuar vazhdimin e hetimit duke pasur parasysh ekzistencën e kushteve dhe kritereve ligjore për caktimin e saj. Në asnjë nen të Kodit të Procedurës Penale nuk thuhet shprehimisht, qartë e pa ekuivok, se masat e sigurimit mund të vendosen rishtazi gjatë gjykimit në themel të çështjes, nga trupi gjykues që e gjykon atë. Kështu, kur çështja penale ndodhet për gjykim dhe nëse i pandehuri nuk ka masë sigurimi, atëherë në fazën e gjykimit nuk mund të kërkohet dhe caktohet rishtazi një masë sigurimi, nëse nga ana e prokurorit nuk ka një akuzë të re për një vepër penale tjetër, apo nuk del gjatë shqyrtimit gjyqësor një fakt i ri, në mënyrë që prokurori të procedojë sipas përcaktimeve të neneve 373, 374 të Kodit të Procedurës Penale.

Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk bashkohemi me mendimin e shprehur nga shumica, e cila ka interpretuar pikën 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale në favor të përfundimit se në çdo fazë të procedimit, duke përfshirë edhe gjykimin, kërkesa e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit duhet të argumentohet në lidhje me mundësinë reale që të ndodhë vënia në rrezik e procesit të të provuarit nga ana e të pandehurit, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për të ndaluar të pandehurin dhe lidhur me nevojën për të caktuar masën e sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit, pasi ashtu si argumentuam më lart, masat e sigurimit vendosen për të garantuar hetimin sa më të plotë dhe në prani të të pandehurit, ndërkohë që faza e gjykimit rregullohet me dispozitat e titullit VII "Gjykimi" në Kodin e Procedurës Penale. Në këtë pjesë të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se për të pandehurin, i cili nuk paraqitet në gjykim, i fshihet gjykimit, nga ana e gjykatës që gjykon çështjen deklarohet mungesa e tij dhe vazhdon gjykimi në mungesë, në prani të mbrojtësit.

Ndërkohë që në dispozitat procedurale penale që rregullojnë gjykimin në mungesë, nuk ka ndonjë rregullim të tillë, që në rastin e mosparaqitjes së të pandehurit në gjykim, prokurori të kërkojë caktimin e një mase sigurimi nëse i pandehuri nuk ka masë. Ky përfundim mbështetet dhe në praktikën e vazhdueshme gjyqësore.

Në lidhje me marrjen e provave, ato janë siguruar dhe mbledhur gjatë procesit të hetimit. Organi i prokurorisë i ka mbledhur provat mbi të cilat do të mbështesë procesin e të provuarit të akuzës ndaj të pandehurit. Mënyra e marrjes në shqyrtim të provave në gjykim bëhet me vendim të trupit gjykues që urdhëron marrjen ose jo të provave të kërkuara nga palët, të atyre provave që nga ana e prokurorit janë siguruar gjatë hetimit paraprak dhe një pjesë e rëndësishme e tyre, kryesisht ato shkresore e materiale, i janë bashkangjitur kërkesës së prokurorit për gjykim, në përputhje me nenin 332 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë dispozitë, ndër ato ç'ka i bashkohen kërkesës për gjykim janë dhe aktet për marrjen e masave të sigurimit (neni 332/1-c i Kodit të Procedurës Penale), që na forcon më shumë bindjen që masa e sigurimit vendoset gjatë hetimeve paraprake.

Në favor të mendimit të mësipërm është edhe interpretimi i nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht i pikës 2 të tij, ku përcaktohet se: "*Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim"*. Në një interpretim literal të këtij neni, së pari do rezultonte se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit në të njëjtin procedim, ndërsa në një lexim të dytë integral të tekstit të dispozitës, rezulton nga një deduksion literal që masat e sigurimit vendosen (vetëm) gjatë hetimit paraprak.

I lexuar neni 15 i Kodit të Procedurës Penale edhe në kontekstin e nenit 231 të Kodit të Procedurës Penale (zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal) dhe nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale (revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit), mund të arrihet në një konkluzion logjik që gjatë gjykimit në themel të çështjes, masat e sigurimit vetëm mund të zëvendësohen, bashkohen, revokohen, por nuk mund të vendosen rishtazi (pra për herë të parë) nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen.

I vetmi rregullim procedural penal që implikon vullnetin dhe veprimtarinë e gjykatës gjatë gjykimit në themel të çështjes (paragrafi 4 i nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale), me masat e sigurimit, e lejon këtë vetëm në lidhje me "revokimin ose zëvendësimin". Në të dyja rastet, si në revokim, ashtu dhe në zëvendësim, gjykata thjesht vendos në lidhje me një çështje fakti, pa i hyrë arsyetimit nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova që tregon se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet, arsyetim i domosdoshëm në rastin kur masa e sigurimit vendoset për herë të parë dhe që bëhet nga gjyqtari që shqyrton kërkesën për caktimin e masës së sigurimit në hetimin paraprak. Në zëvendësimin e masës së sigurimit, gjykata thjesht do të marrë dijeni nga prokurori se janë rënduar nevojat e sigurimit, apo nga i pandehuri se janë zbutur nevojat e sigurimit, apo kanë rënë kushtet dhe kriteret e zbatimit të masës, e për këtë shkak do të vendoset nën një regjim të ri, më të ashpër sigurie (në rastin e kërkesës së prokurorit për zëvendësim mase). Kjo vendimmarrje e gjykatës nuk e implikon aspak atë (gjykatën) në sytë e të pandehurit.

Në të kundërt, çfarë do të ndodhte nëse për të pandehurin pa masë sigurimi prokurori do të kërkonte në gjykimin në themel caktimin e një mase sigurimi, në kushtet kur nuk ka asnjë rrethanë të re, akuzë a fakt të ri? Sigurisht që gjyqtari, në momentin që do të shqyrtonte në gjykim kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, do të shqyrtonte kushtet dhe kriteret, sigurisht do analizonte rrethanat e veprës penale, veprimet e mundshme të personit të pandehur, provat, në të cilat do të bazohej kërkesa për masë (që do të ishin provat e sjella në gjykim nga prokurori për të provuar akuzën ndaj të pandehurit), veprime që do të çonin në vënien në dyshim të paanësisë së gjyqtarit apo të trupit gjykues në sytë e të pandehurit. Gjykata automatikisht do të paragjykohej nga i pandehuri si një gjykatë e njëanshme. Një vendim për caktimin e masës së sigurimit nga i njëjti trup gjykues që gjykon çështjen në themel nuk do të merrej pa krijuar tek gjyqtarët, qoftë edhe minimalisht, bindjen se individi i akuzuar është ai që ka kryer veprën, gjë që bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë, e kështu do të rrëzohej paanësia e tyre objektive dhe vendimi përfundimtar do të ishte i paragjykuar dhe do të konsiderohej si një produkt i një procesi të parregullt ligjor.

Përfundimisht, mendojmë se duheshin prishur të dy vendimet dhe të rrëzohej kërkesa e organit të prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit.

Anëtarë: Besnik Imeraj, Majlinda Andrea, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Andi Çeliku, Guxim Zenelaj.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.1.2012
Doli nga shtypi më 22.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë